



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2020:063428

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05458940

C.nr.159/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, ndaj të paditurit H.K nga fshati Pastasellë, Komuna e Rahovecit, tani me adresë të vendbanimit të panjohur, me bazë juridike kthimin e mjeteve financiare të fituara në mënyrë të kundërligjshme, me vlerën e objektit të kontestit prej 330.00 euro, jashtë seancës, më datën 15.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia e paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, ndaj të paditurit H.K nga fshati Pastasellë, Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike kontestimore, C.nr.159/2020.

Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në këtë gjykatë më datë 05.03.2020, ka parashtruar padinë kundër të paditurit H.K nga fshati Pastasellë, Komuna e Rahovecit, tani me adresë të vendbanimit të panjohur, me bazë juridike kthimin e mjeteve financiare të fituara në mënyrë të kundërligjshme, me vlerën e objektit të kontestit prej 330.00 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë të paditurit i ka dërguar aktvendimin me numër C.nr.159/2020 të datës 20.02.2023 për përgjigjen në padi në adresën e dhënë nga paditësja në, por e njëjta është kthyer me konstatimin se i njëjti është shpërngulur në Prizren.

Kjo gjykatë me aktvendimin me numër C.nr.159/2020 të datës 18.12.2023 e ka detyruar të paditurën që brenda afatit prej 15 ditëve ta plotësojë, ta precizojë padinë duke i rregulluar të dhënat gjeneralë të të paditurit, eventualisht të propozojë përfaqësues të përkohshëm, me pasuesin që do të konsiderohet e tërhequr padia nëse nuk vepron sipas këtij aktvendimi, ndërsa në qoftë se kthehet pa u korrigjuar gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia. E njëjta përmes përfaqësuesit të saj, Avokatura Shtetërore, me parashtrësën e datës 12.01.2024, të

cilën kjo gjykatë e ka pranuar më datën 17.01.2024, duke pasur parasysh kushtet e krijuara, i ka propozuar gjykatës që të ndërpritet procedura në këtë çështje kontestimore. Kjo gjykatë me aktvendimin e saj të datës 22.01.2024 e ka refuzuar propozimin për ndërprerjen e procedurës kontestimore me arsyetimin se në nenin 277 të LPK-së në mënyrë taksative janë të parapara arsyet për ndërprerjen e procedurës dhe ky propozim nuk gjen mbështetje në asnjërën pikë të kësaj dispozite ligjore dhe e ka detyruar paditësen që në afatin prej 7 ditëve të shumën e të hollave prej 500.00 euro në për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe gjykatës t'ia prezantojë dëshminë e pagesës së kryer.

Me dispozitën e nenit 79.3 pika a) te Ligjit te Procedurës Kontestimore shprehimisht thuhet *“gjykata do ti caktoj palës se paditur përfaqësuesin e përkohshëm, në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë”*, kurse me dispozitën e nenit 81.1 të po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet se, *“gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve”* ndërsa me dispozitën e paragrafit 2 te nenit 81 të po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet *“në rastet nga paragrafi 2 i nenit 79 të këtij ligji i padituri ka për detyrë të deponoj shumën e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjti nen shpenzimet i deponon paditësi”*. Gjithashtu, neni 391 i LPK-së parasheh që *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: g) paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligji”*.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi bazuar në nenin 79.3 pika a), 81.1 dhe 2, 391 pika g) dhe 142.2 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.159/2020, më datën 15.03.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.